



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.323/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Republika e Kosovës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Manushaqe Bytyqi nga Prishtina, kundër të paditurës sh.p.k [“A...”], me seli në Vushtrrisë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [B.SH], avokat nga Prishtina, me objekt kontesti Kthimi i Mjeteve, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.110/2018, të datës 29.07.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.07.2020, mori këtë:

AKT GJYKIM

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e paditësit Republika e Kosovës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë dhe të paditurës sh.p.k [“A...”] me seli në Vushtrrisë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.110/2018, të datës 29.07.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses-kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurës- kundër paditëses sh.p.k [“A...”] me seli në Vushtrri, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura kundër paditësja që në emër të mos përmbushjes së kontratës me numër ... të datës 17.11.2016, për financimin e projekteve investues te Zhvillimit Rural t’ia kthej mjetet në shumën prej 85,000.00€, me kamatë ligjore, brenda afati prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ndërsa në piken II të dispozitivit është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e të paditurës kundër të paditëses sh.p.k [“A...”] me seli në Vushtrri e paraqitur kundër paditëses kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me

seli në Prishtinë ashtu që detyrohet paditësja kundër e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, që në emër të përmbushjes së kontratës të paditurës kundër paditëses t'ia paguaj shumën e mjeteve në lartësi prej 25,700.00€ me kamatë vjetore në lartësi prej 8% e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të kundërpadisë në gjykate data 15.04.2019 e deri në pagesën definitive të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit është refuzuar pjesërisht si e pa bazuar kërkesa e te paditurës kundër paditëses sh.p.k ["A..."] me seli në Vushtrri e paraqitur kundër të paditurës kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, ku ka kërkuar që në emër të përmbushjes së kontratës së lartë cekur paditësja kundër e paditura t'ia paguaj edhe shumën e mjeteve në lartësi prej 69,300.00€ me kamatë ligjore e cila fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së kundërpadisë data 15.04.2019, e deri në pagesën definitive, brenda afati prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Dhe në pikën IV të dispozitivit është detyruar paditësja kundër e paditura që palës së paditur kundër paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 832,16€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditësi Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Agjencia Për Zhvillimin e Bujqësisë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës material dhe konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit në Prishtinë që ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthejë çështjen në rigjykim në gjykatën shkallës së parë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë edhe pala e paditur kundër paditësi ["A..."] sh.p.k me seli në Vushtrri për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plote të gjendjes faktike. Me propozimin që Gjykata Apelit që për pikat II, III dhe IV të dispozitivit të Aktgjykimit V.EK.nr.110/2018 i datës 29.07.2019 ta aprovon ankesën si të bazuar dhe të prishe pikat II, III dhe IV të Aktgjykimit të kundërshtuar me këtë ankesë dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi kundër e paditura Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës - kundër paditëses ["A..."] sh.p.k, me seli në Vushtrri, për kthimin e mjeteve për shkak të mos përmbushjes së kontratës.

E paditura - kundërpaditësja Sh.p.k ["A..."] me datën 15.04.2019 ka paraqitur kundërpadi kundër paditëses kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, për mos përmbushje të kontratës.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur se palët ndërgjyqëse kanë qenë në raport juridiko-kontraktues, në bazë të kontratës ..., ku paditësja-kundërpaditura ka marrë për detyrim që të paditurën-kundërpaditësen ta përkrahë përmes projektit për financimin e zhvillimit rural, deri në shumën prej 170,000.00 €. Paditësja-kundërpaditura ia ka paguar në emër të investimeve të bëra shumën prej 85,000.00 €. Pas kësaj ka marrë vendimin për refuzimin e përkrahjes investuese, me pretendim se pala tjetër nuk i është përmbajtur planit të biznesit dhe ka kërkuar kthimin e mjeteve të paguara në emër të avansit, në shumë prej 85,000.00. Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të ndërtimtarisë z. [N.M], të dhënë në ekspertizën e datës 12.06.2019, dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se e paditura-kundërpaditësja i është përmbajtur planit të biznesit dhe ka kryer investime në ndërtimin e fabrikes së përpunimit të mishit, ka ndërtuar objektin dhe ka blerë makinëri, në shumën prej 227,400.00 €. Këto investime janë bërë në përputhje me kontratën dhe planin e biznesit të prezantuar në momentin e aplikimit. Andaj bazuar në gjetjet e sipërcekura ka aprovuar pjesërisht kundërpadinë e të paditurës-kundërpaditësit në shumën prej 25,700.00 €, respektivisht 50% të investimit të konstatuar prej 227,400.00 €, pasi ka konsideruar se e paditësja-kundërpaditura në bazë të kontratës ka pasur detyrim t'ia paguaj në emër të 50% të financimit shumën prej 113,700.00 €, nga të cilat ia ka paguar shumën prej 85,000.00 €, ndërsa ka mbetur në detyrim për shumën prej 25,700.00 €. Gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesëpadinë e të paditurës-kundërpaditëses në shume prej 59,300.00 €, sepse ka gjetur se shuma e parovuar është në përputhje me investimet e kryera, ndërsa kërkesëpadia mbi shumën e aprovuar është e pabazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 8 par të LMD-së, i cili përcakton se: *“pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”* dhe nenin 245 par.1 të LMD-së, i cili parasheh se *“kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht si kundër është përmbushja e tij”*. kur ka aprovuar kërkesëpadinë e të paditurës-kundërpaditëses dhe e ka detyruar të paditësen-kundërpaditurën t'ia paguaj palës shumën prej 25,700.00 €, në emër të pagesës së pjesës së mbetur të 50% të të financimit të investimit të konstatuar prej 227,400.00 €. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur edhe kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e të paditurës-kundërpaditëses në shume prej 59,300.00 €, sepse kërkesëpadia mbi shumën e aprovuar është e pabazuar pasi e paditura-

kundërpaditësja nuk ka arritur që ta argumentojë me prova bazueshmërinë e kërkesëpadisë për këtë pjesë.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet ankimore të dy palëve, por gjeti se janë të pabazuara për arsye se nga shkresat e lëndës, përfshirë kontratën me numër ... të datës 17.11.2016 për financimin të projekteve investuese të zhvillimit rural, raportin e Komsionit për kontrollimin-monitorimin e investimeve të bëra, të datës 11.08.2017, dhe Raportin plotësues të datës 05.10.2017, e sidomos nga ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë z. [N.M], e datës 12.06.2019, e cila përputhet plotësisht me provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton se, me kontratën me numër ... të datës 17.11.2016 për financimin të projekteve investuese të zhvillimit rural, së paditësja-kundërpaditura ka marrë detyrim financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural. Sipas kontratës totali i përkrahjes publike ka qenë 50-60% e shumës së përgjithshme dhe atë e shprehur në mjete monetare në lartësi prej 199,262.50€, ndërsa shuma e përgjithshme e investimit të pranuar me kontrate ka qenë në shumën e mjeteve në lartësi prej 331,000.00€. E paditura-kundërpaditësja në përputhje me kontratën dhe planin e biznesit të prezantuar në momentin e aplikimit, ka kryer investime në ndërtimin e fabrikës së përpunimit të mishit, ka ndërtuar objektin dhe ka blerë makinëri, në shumën prej 227,400.00 €. Paditësja-kundërpaditura ka pasur obligim që në emër emër të 50% të financimit shumën t'ia paguaj shumën prej 113,700.00 €, nga të cilat ia ka paguar shumën prej 85,000.00 €, ndërsa ka mbetur në detyrim për shumën prej 25,700.00 €.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet ankimore lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara dhe në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Të njëjtat pretendime palët i kanë parashtruar edhe në gjykatën e shkallës së parë ndërsa gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë dhe drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për secilin pretendim të palëve ndërgjyqëse, të cilat i aprovon plotësisht edhe kjo gjykatë.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr. 323/2019, dt. 13.07.2020

KRYETARI I KOLEGJIT,

Mahir Tutufi, d.v.

